

JAVA E GRUAS
NEDELJA ŽENE
WEEK OF WOMEN
2014



● Çka është Java e Gruas 2014?

Java e Gruas do të mbledhë gratë lidere të së ardhmes nga të gjitha segmentet e shoqërisë për të marrë pjesë në një javë diskutimi ku ato do të mund të diskutojnë, mësojnë dhe forcojnë shkathtësitë dhe teknikat për tu bërë më efektive në fushën e tyre.

● Kush do të marrë pjesë në këtë ngjarje?

Në këtë ngjarje do të marrin pjesë njëqind (100) gra duke përfaqësuar partitë politike, kuvendin, qeverinë, qeverisjen lokale, mediat, universitetet, shoqërinë civile dhe biznesin. Java e Gruas në Kosovë do të reflektojë po ashtu pjesëmarrjen e barabartë nga të gjitha regjionet e Kosovës si për nga etnia ashtu edhe nga mosha.

● Ku do të mbahet Java e Gruas 2014?

Java e Gruas 2014 do të mbahet në Prishtinë në Hotelin Swiss Diamond, Innovation Centre Kosovo (ICK) dhe në Kolegjin Universum. Për më shumë detaje ju lutem konsultoni agjendën dhe faqen tonë të internetit në www.weekofwomen.org



www.weekofwomen.org

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) është organizatë jo profitabile që punon për të fuqizuar dhe zgjeruar demokracinë në mbarë botën. Duke u thirrur në rrjetin global të ekspertëve vullnetarë, NDI ofron ndihmë praktike për liderët e shoqërisë civile dhe partive politike duke i avancuar vlerat demokratike, praktikat dhe institucionet. NDI punon me demokratët në çdo rajon të botës për të ndërtuar organizatat politike dhe të shoqërisë civile, zgjedhje të sigurta duke promovuar pjesëmarrjen qytetare, transparencën, dhe përgjegjshmërinë nga Qeveria. Asistenca financiare dhe teknike per NDI për ngjarjen e Javës së Gruas është pjesë e një programi të gjerë të financuar nga USAID për nxitjen e qeverisjes efektive në nivelin lokal dhe qëndror nga partitë politike, të zhvillojë lidërshtipin e partive politike nga rradhët e komuniteteve, të rrisë besimin e qytetarëve në procesin e zgjedhjeve dhe mundësohet nga mbështetja bujare e popullit Amerikan. Për më shumë informata për NDI, ju lutem konsultoni faqen tonë në internet: www.ndi.org

● Të dhëna nga Java e Gruas 2013


- Java e Gruas në vitin 2013 solli së bashku 100 gra nga e gjithë Kosova. Ngjarja është mbajtur me 25-29 Mars 2013 në Prishtinë. Pjesëmarrëset e Javës së Gruas 2013 ishin Deputetet e Kuvendit të Kosovës, Këshilltaret Komunale, aktivistet e partive politike, gratë të cilat planifikojnë të garojnë në zgjedhjet e ardhshme, profesoret dhe studentet nga Universiteti, gra nga biznesi, shoqëria civile dhe mediat.
- Gratë deputete ishin nikoqire të Javës së Gruas 2013 dhe kanë qenë prezente në të gjitha sesionet.
- Temat e trajtuara gjatë Javës së Gruas 2013 ishin: Gratë në Zgjedhjet Lokale, Karriera Politike: Marrja e vendimit për të kandiduar, Udhëheqja e fushatave të suksesshme, Demokracia brenda partive politike – Fuqizimi i Gruas, si dhe Gratë dhe Zgjedhjet Lokale.
- Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga ka marrë pjesë në hapjen dhe mbylljen e Javës së Gruas 2013. Ajo u është drejtuar të pranishmëve me një fjalim inspirues dhe ka qenë nikoqire e hapjes së programit për gratë pjesëmarrëse.
- Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Tracey Ann Jacobson u është drejtuar grave pjesëmarrëse me një fjalim inspirues në hapjen e Javës së Gruas 2013.
- Gjatë sesioneve të pasdites pjesëmarrëset kanë pasur mundësinë të marrin njohuri në fusha të ndryshme nga këshilltaret ndërkombëtare: znj. Pamela Hart, znj. Susan Markham, znj. Judy Wasylcia – Leis dhe z. Nate Evans.
- Në Javën e Gruas 2013, nikoqirë të darkave për gratë pjesëmarrëse ishin: Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ambasada e Finlandës. Ndërsa Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë ka qenë nikoqire e njëjës nga drekat për pjesëmarrëset e Javës së Gruas 2013.
- Pas Javës së Gruas 2013, NDI ka hartuar dhe implementuar Akademinë e Grave për Leadership me pesë module duke synuar ofrimin dhe zhvillimin e shkathtësive shtesë për gratë pjesëmarrëse. 30 nga 100 pjesëmarrëset e Javës së Gruas 2013 janë përzgjedhur për të ndjekur Akademinë e Grave për Leadership.
- Shumë gra pas Akademisë së Grave për Leadership, me iniciativën e tyre vazhduan të punojnë së bashku në projekte të ndryshme specifike duke përjashtuar ngjyrimet e përkatësisë politike dhe rajonale. Shembull kemi iniciativën për mbrojtjen e të drejtave të nënave vetëushqyese dhe fëmijëve të tyre.

Kontaktet e stafit të NDI

NITA BICURRI
email: nbicurri@ndi.org
mob: +377 45 318 486

BARDHA UKA
email: buka@ndi.org
mob: +377 44 444 158

ADRESA E NDI
Rr. "Andrea Gropa" no.1
10000 Prishtinë, Kosovë



● Swiss Diamond Hotel
● ICK- Innovation Center Kosovo

● Kolegji Universitar - Universum

Ne ju rekomandojmë këto shërbime të taksit nëse keni nevojë për to.

LONDON TAXI
+377 44 300 300

TAXI ROBERTI
+377 44 111 999

TAXI VICTORY
+377 44 111 222